Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

287/20

02.06.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	**01 qershor 2020**
REFERENCË:	**287/20**
PËR/ZA/TO:	**AK- KEK**
NGA/OD/FROM:	**Blerim Dina** **Kryetar i panelit shqyrtues- OSHP**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**NJOFTIM**

Operatori ekonomik "ND" SH.P.K-Prishtinë, si palë e pakënaqur me datën: 08 maj 2020, ka parashtruar në OSHP ankesën me numër 287/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me filtera për seperator të vajit të turbines B1&B2" me numër të prokurimit: KEKO-20-083-121, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- Neni 1, 7, 28, 59, 60 dhe 69 të LPP-së, nenin 9.1&9.2 dhe nenin 31.1 të FDT-së si dhe neni 4.6 i Kodit Etik të Prokurimit.

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 18 maj 2020 kanë autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Eksperti shqyrtues me datën 28 maj 2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-se për dhënie te kontratës te anulohet dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Autoriteti kontraktues- Korporata Energjetike e Kosovës me datën 28 maj 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit shqyrtues dhe të njëjtit me datën 29 maj 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues me datën 28 maj 2020 ka pranuar nga OSHP raportin e ekspertizës dhe të njëjtit përmes parashtresës me shkrim me datën 31 maj 2020 kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së që **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues- Korporata Energjetike e Kosovës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me filtera për seperator të vajit të turbines B1&B2" me numër të prokurimit: KEKO-20-083-121, duhet të anuloj njoftimin mbi vendimin e AK-së, për dhënie dhe lënda të kthehet ne rivlersim, konform mendimit te dhënë ne raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik "ND" SH.P.K-Prishtinë konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.